Edhe një herë: Natyrisht që shkolla është një vend, në të cilin mësojnë të rinjtë. Por konvikti ynë nuk është arsyeja e vetme, pse Loyola duhet të jetë gjithashtu një vend, në të cilin të rinjtë mund të jenë dhe të jetojnë aty, të shpalosin dhe të provojnë gjëra të reja, të mbledhin përvoja të ndryshme dhe të mund të bëjnë edhe gabime. Fëmijët dhe të rinjtë kurrë nuk janë vetëm nxënës, ata janë njerëz të rinj me perspektivë të veten, me parafytyrimet dhe dëshirat e veta. Kjo nuk do të thotë që duhet të ndiqen vetëm dëshirat e tyre, që të hiqen parafytyrimet dhe të përjashtohen perspektivat tjera. Por kjo do të thotë, që ne duhet të testojmë, nëse ne ofrojmë apo hapim mundësi të mjaftueshme rreth asaj, a po bëjmë përvojë përmes të mësuarit në shkollë. Natyrisht që ndodhin shumë gjëra të thjeshta gjatë përditshmërisë së shkollës: Vëmendja për tjetrin apo egoizmi në autobusin e shkollës ose në menzë, pastërtia dhe ndarja e mbeturinave në oborrin e shkollës, të qenurit i drejtë apo egoizmi në futboll nuk janë përvoja të konstruktura, por jeta e vërtetë. Parlamenti i shkollës, garat akademike, sjelljet me njëri tjetrin në klasë e në dhomën e konviktit dhe shumë të tjera e meritojnë poashtu vëmendjen dhe mbështetjen tonë sikurse edhe kontrollimi i testeve të fjalëve dhe i detyrave të shtëpisë.



Gymnasium

Drei Sterne für das Loyola-Gymnasium

zung wie die regelmäßige Überprüfung von Vokabeln oder Hausaufgaben.

Sport, Musik hören und selbst Musik machen, Kunst betrachten und selbst gestalten, Theater, ... – es gibt zahllose Bereiche, die wir Jugendlichen eröffnen können, um sie zu ermutigen zu wachsen, indem sie ihre Begabungen entdecken und entfalten.

Wenn Kinder und Jugendliche in diesem Prozess des Wachsens Fehler machen, oder wenn sie sich, gemessen an unseren Vorstellungen und Erwartungen, falsch verhalten, dann ist das manchmal für die Erwachsenen sehr ärgerlich oder unverständlich. Ich persönlich halte manche Fehler für unvermeidlich, damit eine gute und gesunde Entwicklung voranschreiten kann. Das sage ich nicht, um Fehler zu verharmlosen oder alle Regeln und Erwartungen aufzugeben. Aber nicht selten habe ich erlebt, wie aus einem Fehlverhalten und den damit verbundenen Konsequenzen ein großer Fortschritt wurde. Deshalb ist eine Schule und ein Internat nicht dann ein guter Ort, wenn dort niemand Fehler macht, sondern wenn dort auf eine hilfreiche und klare Weise auf Fehler reagiert wird. Dabei ist unter anderem wichtig, dass die Spielregeln im Vorhinein allen Beteiligten verständlich erklärt und von allen akzeptiert, möglicherweise sogar gemeinsam ausgehandelt wurden, und dass sie für alle gelten.

Nicht nur lernen, sondern auch dienen

Die herausragenden Ergebnisse, die unsere Schülerinnen und Schüler jedes Jahr aufs Neue erreichen, zeigen, wie fleißig und einsatzbereit junge Menschen in Kosovo sind. Ihre Motivation und ihr Wille, etwas zu erreichen, sind groß. Am Loyola-Gymnasium haben wir bereits vor vielen Jahren mit der Ausbildungsinitiative begonnen, Wege in eine qualifizierte Berufstätigkeit zu ebnen. Inzwischen wächst in Deutschland das verständliche Interesse, mit jungen Kosovaren dem Mangel an Fachkräften zu begegnen. So wächst die Zahl der Projekte, die junge Menschen nach Deutschland vermitteln, in Praktika, Ausbildung oder Arbeit. Am Loyola-Gymnasium wollen wir aber weder junge Menschen für die Anforderungen des deutschen Arbeitsmarktes vorbereiten, noch wollen wir Egoismus und Karrieredenken fördern. Das Anliegen des Loyola-Gymnasiums ist seit seiner Gründung, den Menschen in Kosovo zu dienen, und



Shkolla e mesme

Tre yje për Loyola-Gymnasium

Ka fusha të shumta, të cilat mund t'ua hapim të rinjëve, në mënyrë që t'ua mundësojmë atyre të zbulojnë dhe shpalosim prirjet e tyre, si p.sh. sporti, të dëgjuarit dhe të bërit muzikë, konsiderata ndaj artit dhe marrja me të, teatri, ... e shumë të tjera.

Nëse fëmijët dhe të rinjtë në këtë proces të rritjes bëjnë gabime, ose nëse ata nuk sillen ashtu siç janë paramendimet dhe pritjet tona, atëherë kjo është për ne të rriturit neveritëse dhe e pakuptimtë. Për mua personalisht disa gabime janë të paevitueshme, në mënyrë që kështu të bëhet përparim në një zhvillim të mirë dhe të shëndoshë. Këtë nuk e them për ti minimizuar gabimet ose për t'iu dorëzuar të gjitha rregullave dhe pritjeve. Por jo rrallë e kam përjetuar, se si nga një sjellje e gabuar dhe pasojave të sajë është bërë një progres i madh. Për këtë shkolla dhe konvikti nuk është një vend, në të cilin nuk guxohet të bëhen asnjëherë gabime, por është një vend në të cilin për gabimet e bëra duhet të reagohet duke ndihmuar në mënyrë të qartë. Nga kjo del që, përveç tjerash, është shumë e rëndësishme që rregullat e lojës që në fillim të sqarohen kuptueshëm për të gjithë dhe ato të pranohen nga të gjithë, madje mundësisht ato edhe të negociohen së bashku dhe kështu ato të vlejné për të gjithë.

Jo vetëm të mësojmë, por edhe të shërbejmë

Rezultatet e shquara, të cilat i kanë arritur nxënësit tanë me vite, tregojnë qartë sesa të zellshëm dhe të gatshëm për punë janë të rinjtë në Kosovë. Motivimi dhe dëshira e tyre për të arritur në jetë janë të mëdha. Në Gjmnazhin Loyola kemi filluar tashmë që disa vite me iniciativën e arsimit profesional, në mënyrë që kështu t'iu trasojmë nxënësve rrugën në rrafshin profesional. Në ndërkohë në Gjermani po rritet një interes i kuptueshëm për të plotësuar mungesën e fuqisë punëtore me të rinjë kosovarë. Kështu edhe po rritet numri i projekteve, për t'iu ndërmjetësuar të rinjëve për në Gjermani në lidhje me praktika, arsimim profesional ose edhe punë. Në Gjmnazhin Loyola ne nuk dëshirojmë as të përgatisim njerëz të rinjë për të plotësuar vendet në tregun e punës në Gjermani, e as të mbështesim egoizmin e të menduarit për karrierë. Shqetësimi i Gjmnazhit Loyola që nga themelimi i tij është si ti shërbejmë njerëzve në Kosovë, dhe „njerëz për të tjerë“ është njëri nga caqet e arsimit në kornizat e pedagogjisë Ignaciane.

Për këtë arsye dëshirojmë që duke e mbajtur angazhimin tonë të tanishëm dhe të shumëlojshëm, në të cilën janë të përfshirë shumë njerëz dhe shumë firma, të kërkojmë rrugë të tjera në mënyrë që ti dilet përpara migrimit nga vendi me alternativa konkrete. Një përkthim i nocionit „njerëz për të tjerë“ në kontekstin e Kosovës, më duket mua që duhet të jetë, pra të flitet rreth asaj, që të edukohen dhe inkurajohen „qytetarët e këtij vendi“ në këtë mënyrë: Të rinjë, të cilët dëshirojnë të japin aktivitetin e tyre në vendin e tyre dhe për vendin e tyre. Për këtë për shembull neve na duhen përvoja nga format e procesit demokratik dhe njohuri rreth dinamikës së mediave dhe ekonomisë.

Kjo nuk mund të bëhet e tëra nga shkolla, por ka numër të madh të pikënisjeve në këtë vend, me të cilat ne dëshirojmë ti qesim në kontakt nxënëset dhe nxënësit tanë. Ka modele dhe idole. Dhe ka vullnet dhe energji, të cilat rriten nga një pyetje e papërgjigje, nëse më prek

Gymnasium

Drei Sterne für das Loyola-Gymnasium

„Mensch für andere“ lautet eines der Bildungsziele im Rahmen der Ignatianischen Pädagogik.

Deshalb wollen wir unter Beibehaltung des gegenwärtigen, vielfältigen Engagements, an dem viele Menschen und Betriebe beteiligt sind, nach weiteren Wegen suchen, die Dynamik der Abwanderung aus dem eigenen Land konkrete Alternativen entgegenzusetzen. Eine Übersetzung des Begriffs „Mensch für andere“ im Kontext des Kosovo scheint mir zu sein, davon zu sprechen, dass wir „Bürger dieses Landes“ erziehen und ermutigen wollen: Junge Menschen, die sich in ihrer Heimat und für ihre Heimat einsetzen wollen. Dafür brauchen sie beispielsweise Erfahrungen mit demokratischen Verfahrensformen und Kenntnisse über die Dynamik der Medien und der Wirtschaft.

Das kann nicht alles allein von Schule geleistet werden, aber es gibt eben schon zahlreiche Anknüpfungspunkte im Land, mit denen wir unsere Schülerinnen und Schüler in Kontakt bringen wollen. Es gibt Modelle und Vorbilder. Und es gibt den Antrieb und die Energie, die aus einer unbeantworteten Frage erwachsen, wenn mich diese Frage wirklich betrifft und bewegt. Deshalb wollen wir verstärkt Menschen und Initiativen in die Schule einladen, die unsere Schülerinnen und Schüler ermutigen, sich in ihrer Heimat zu engagieren und mitzuwirken, dass hier ein demokratisches und lebendiges Kosovo entsteht, das seiner Bevölkerung alle Chancen für ein gutes und freies Leben bietet.

Ich denke, dass wir nicht unbescheiden sind, wenn wir am Loyola-Gymnasium auf bewährte und auf neue Weise weiterhin versuchen wollen, gemeinsam mit vielen Partnern hier im Land in diesem Sinne an der Bildung und Erziehung zukünftiger Bürgerinnen und Bürger dieses Landes mitzuwirken.



Shkolla e mesme

Tre yje për Loyola-Gymnasium

mua vërtetë kjo pyetje. Për këtë dëshirojmë ne që në shkollë të jemi të hapur dhe t'iu bëjmë ftesë njerëzve dhe iniciativave që të vijnë në shkollë dhe ti inkuadrojnë nxënëset dhe nxënësit tanë të angazhohen dhe të marrin pjesë në zhvillimin e vendit, në mënyrë që nga kjo të del një Kosovë demokratike dhe e gjallë, e cila do ti ofronte popullatës së saj shansa të mira për një jetë të mirë dhe të lirë.

Unë mendoj që ne nuk jemi të pamodesti kur themi, që ne në Gjimnazin Loyola po përpiqemi edhe më tutje për të gjetur mënyra të provuara dhe të reja, së bashku me partnerët tanë të shumtë në vend, dhe kështu ti bëjmë qytetarët dhe qytetarët e këtij vendi që përmes arsimimit dhe edukimit të bëhen pjesë e ndikimeve në vendin e tyre.



Englisch proverbs translated into Albanian Prof. Mark Gojani

A friend in need is a friend indeed.
Miku i mire në kohë të vështirë.

When the cat's away, the mice will play.
Kur macja s'është në shtëpi, minjtë bëjnë gosti.

Live and learn.
Jeto, mëso.

When there's a will, there's a way.
Kur ka vullnet ka zgjidhje.

All that glitters is not gold.
Çdo gjë që shkëlqen nuk është flori.

All roads lead to Rome.
Të gjitha rrugët shpiejnë në Romë.

Look before you leap.
Bëj hop para se të kërcesh.

If it's worth doing, it's worth doing well.
Nëse ia vlenë të bëhet, bëje mire.

Like father like son.
Si baba s'ii biri.

There's an exception to every rule.
Çdo rregull ka përjashtim.

A leopard never changes its spots.
Gjarpri vesin s'e ndërton.

You can't teach an old dog new tricks.
At' që ka përvojë ta mësosh s'ka nevojë.

Rome wasn't built in a day.
Roma s'është ndërtuar për një ditë.

Experience is the best teacher.
Përvoja është mësuesi më i mire.



Fjalë të urta anglisht përkthyer në shqip Prof. Mark Gojani

Charity begins at home.
Bëmirësia fillon në shtëpi.

Clothes make the man.
Rrobat e bëjnë njeriun.

Don't judge a book by its cover.
Mos e vlerëso librin nga kopertina.

Where there's smoke there's fire.
Ku ka tym, ka zjarr.

A man's home is his castle.
Shtëpia është kështjella e njeriut.

Two heads are better than one.
Dy koka vlejné më tepër se njëra.

Silence is golden.
Qetësia është e artë.

Don't put all your eggs into one basket.
Mos i vë të gjitha vezët në një shportë.

You can't get blood from a stone.
S'mund të nxjerësh ujë nga guri.

Money isn't everything.
Paraja s'është çdo gjë.

Time flies when you have a good time.
Koha ecën shpejtë kur ia kalon mire.

There's no place like home.
S'ka më mire se n'shtëpi tëndë.

You are what you eat.
Më trego çfarë ha, të trego çfarë je.

The fruit doesn't fall far from the tree.
Fruti nuk bie larg nga pema.

Gymnasium

English lesson in the canteen Prof. Pranvera Pupa

In the third week of November, the English lesson for the students of grade IX was held in the canteen.

Together with students, we organized to cook and eat Japanese food.

In addition to prepare the Japanese food, they had to learn the English vocabulary for the necessary materials, spoon, fork and dishes. During the tasting of Japanese food, we were not discussing in Japanese, but only in English.

For some of them it had a Japanese taste and for the others English taste. However, it tasted delicious.



Gjuhë angleze në menzë Prof. Pranvera Pupa

Në javën e tretë të nëntorit, mësimi i gjuhës angleze për klasat e IX-ta, u mbajt në menzë. Së bashku me klasat e nënta, organizuam të përgadishim dhe të hanim ushqim japonez.

Krahas përgaditjeve të specialiteteve japoneze ose të atyre që u quajtën ashtu, natyrisht që duhej të mësohej edhe i gjithë fjalori për materialet e nevojshme, si traditat e të ushqyerit, të mësohen luga, piruni dhe enët. Gjatë shijimit të gatimeve tona nuk u diskutua në japonisht, por vetëm në gjuhën angleze.

Ishte e shijshme për të gjithë. Për disa shija japoneze, të tjerëve shija angleze. Sidoqoftë, ajo ishte shumë e shijshme.



Shkolla e mesme

„Maya the Bee“ Prof. Pranvera Pupa

On that day, the students of grade VII, had a different lesson from other times. We went to the cinema, where we watched the English version of the film „Maya the Bee“.

Of course that was fun, but it did not end here. Since children need to discuss about the film, we decided to gather at a Fast food, where we had dinner together, and discuss about the film. It was a wonderful night.



„Bletëza Maja“ Prof. Pranvera Pupa

Në atë ditë, klasat e VII-ta, mbajtën një mësim pak më ndryshe nga herët e tjera. Ne shkuam në kinema, ku u shikua versioni anglisht i filmit „Bletëza Maja“.

Natyrisht që ishte argëtuese por kjo nuk përfundoi këtu. Pasi që fëmijët duhej të diskutonin për filmin pikërisht në gjuhën angleze, ne vendosëm të mblidhemi në një Fast Food ku kishim mundësi të darkojmë të gjithë së bashku dhe të diskutojmë rreth filmit. Ishte një natë e mrekullueshme.




Pak histori për lëndën e gjeometrisë Prof. Fuat Berisha & prof. Veli Gashi

Në aktivin e matematikës në këtë shkollë bëjnë pjesë këta arsimtarë: Fuat Berisha, Veli Gashi, Faton Kabashi, Mirlinda Selimaj dhe Shqipe Sharani. Raportet në mes arsimtarëve janë shumë të mira dhe gjithherë bisedohet për tema të rëndësishme të lëndës së matematikës, po kështu trajtohen edhe tema të përgjithshme dhe interesante që kanë të bëjnë mbi materien e matematikës. Shumë herë bisedohet për nivelin dhe kapacitetet e nxënësve në lëndën e matematikës.


Duke pasur parasysh se në një vjetar të shkollës kemi paraqitur jetën dhe punën e matematikanëve si Pitagora dhe Euklidi në lidhje me mësimet e gjeometrisë, këtë herë do të paraqesim një punim tjetër të zhvillimit të gjeometrisë së shekullit XIX, Gjeometria joeuklidiane (N. I. Lobachevsky 1792–1856):

Aksioma e paraleleve:

Deri në shekullin XIX ishte e njohur si aksioma e paraleleve, e cila njihet me emrin „Postulata e V e Euklidit“, e cila thotë: „Nëpër një pikë jashtë një drejtëze mund të tërhiqet një dhe vetëm një drejtëz paralele me drejtëzën e dhënë“.



Duke u bazuar në këtë aksiomë (Postulatin e V) është ndërtuar një teori e gjerë në lidhje me këtë aksiomë, janë vërtetuar edhe shumë teorema. Historikisht dihet se këto përpjekje dështuan dhe u krijua idja e lindjes së një gjeometrie të re, e cila u quajt Gjeometria joeuklidiane.



Matematikani rus, N. I. Lobachevsky kuptoi se kjo aksiomë nuk mund të trajtohet si teoremë, ai formuloi mohimin e saj, e cila thotë: „Nëpër një pikë jashta një drejtëze mund të tërhiqen së paku dy drejtëza paralele me drejtëzën e dhënë“.

Lobachevsky vuri re se ky supozim i marrë si i vërtetë, së bashku me aksiomat e tjera, formojnë një gjeometri të re të ndryshme nga ajo e Euklidit. Nga kjo shihet se gjeometria e Euklidit është një rast special i gjeometrisë së Lobachevskyit.

Më vonë matematikani gjerman Bernad Rimani (1826–1866) aksiomën e Euklidit e zëvendësoi me një tjetër pohim: „Nga një pikë jashtë një drejtëze nuk kalon asnjë drejtëz paralele me të.“ Duke zëvendësuar Postulatin V të Euklidit me këtë pohim Rimani ndërtoi një gjeometri tjetër joeuklidiane.

Plani i Lobachevskyit paraftrohet i lugët (kthyer) si pjesë e brendshme e sipërfaqes e sferike. Plani i Rimanit paraftrohet si pjesë e jashtme e sipërfaqes sferike. Gjeometria e Rimanit për dallim nga dy të tjerat që kanë konceptin e pafundësisë nuk e ka këtë koncept. Këto drejtëza paralele takohen siç takohen meridianet e globit tokësor. Përderisa këto tri gjeometri nuk kanë në brendësinë e tyre kundërshtime, atëherë bëhet pyetja: Cila është më e përshtatshme për ta shpjeguar botën tonë fizike?



Gjeometria Euklidiane është e thjeshtë dhe mund të zbatohet në jetën tonë të zakonshme, natyrisht me distanca të vogla deri në disa milion kilometra. Gjeometria joeuklidiane i përshtatet UNIVERSIT në të gjithë gjerësinë e tij. Sipas teorisë së relativitetit të Ajnshtajnit gjeometria e botës fizike nuk është Euklidiane, asaj i përshtatet më mirë gjeometria e Rimanit.

**Pater Walter Happel
ist Ehrenbürger
der Stadt Prizren**

Der Gründungsdirektor, Pater Walter Happel SJ, hatte am 16. April 2015 unter Anteilnahme vieler Eltern, Schüler und Besucher sowie in Anwesenheit von Militärgeneralvikar Msgr. Reinhold Bartmann und zahlreicher weiterer Gäste den 10. Jahrestag der Grundsteinlegung „seines“ Loyola-Gymnasiums begehen können. Kurz darauf wurde ihm nun auch ganz persönlich der Dank der Stadt Prizren für sein unermüdliches und geradliniges Engagement für die Bildung der Kinder und Jugendlichen zuteil.

In einer festlichen Sitzung des Stadtparlaments von Prizren wurde ihm die Ehrenbürgerwürde verliehen. Doch bevor es dazu kam, trug er sich beim Bürgermeister in das Goldene Buch der Stadt ein. Als dann Punkt 4 der Tagesordnung aufgerufen wurde, ließ es sich keine der vertretenen Parteien nehmen, die Verdienste von Pater Happel zu würdigen. So gab es bei der formalen Abstimmung über den Antrag, den Jesuiten in die Reihe der Ehrenbürger Prizens aufzunehmen, auch keine Gegenstimmen.

Der Bürgermeister überreichte ihm darauf eine Urkunde und eine Schärpe, sowie den symbolischen Schlüssel der Stadt. Äußere Zeichen, die somit für jeden sichtbar machen, dass Walter Happel fortan Ehrenbürger der altherwürdigen Stadt Prizren ist.

Beim anschließenden Empfang der Stadt konnte Pater Happel nicht nur seinen designierten Nachfolger als Direktor des Loyola-Gymnasiums, Pater Axel Bodefeld SJ, sondern auch zahlreiche Weggefährten und Freunde der vergangenen zwölf Jahre begrüßen. Unter diesen waren u. a. auch Würdenträger der islamischen Glaubensgemeinschaft, der katholischen Kirche des Kosovo, des Deutschen Einsatzkontingents KFOR sowie der katholischen und Evangelischen Militärseelsorge – und vor allem natürlich die, für die sein Herz ganz besonders schlägt, nämlich Schülerinnen und Schüler des Loyola-Gymnasiums Prizren.

Pastoralreferent Thomas Nuxoll,
Militärseelsorger, z. Zt. Einsatzbegleitung Kosovo



© Loyola-Gymnasium (3)



Në shkollë përveç mësimi na jepet mundësia, që të shijojmë pushimet madje edhe të pasurojmë dijet tona të përgjithshme mbi kultura të ndryshme, e kjo veçanërisht kur je maturant. Në fillim të këtij viti u gjendëm pranë një dileme të madhe, asaj se ku do të kalonim ekskurzionin e fundit së bashku. Kishte propozime të shumta, mirëpo e vështirë na dukej të vendosnim se ku dëshironim të shkonim. Pas shumë diskutimesh, vendosëm për një program të pasur kulturor ku përfshihejshin, tri vende për ti vizituar. Pra, do të shkonim në Kroaci ku do

ta kalonim pjesën më të madhe të kohës, në Venecia dhe në Slloveni. Një oferte të tillë pa dyshim se nuk i rezistuar dot. Filluam që të bëheshim gati ta shijonim sa më mirë sepse do të ishte ekskurzioni i fundit që do ta kalonim së bashku.

Ndonëse rruga ishte pak e gjatë dhe e mundimshme të kaloje të gjithë ata kufinj, mendimi se do të kënaqeshim pa masë nuk e ndjenim lodhjen. Kështu në mesditë arritëm në Poreq dhe u vendosëm në hotel. Gjithçka dukej në rregull. Gjatë ditëve sa ishim në Kroaci, pasuruar programin tonë duke vizituar shumë qytete tjera si: Rovinj, Pula, madje patëm rastin ta vizitonim edhe arenën e madhe. Në mbrëmje kishim mundësinë të organizonim në hotel muzikë apo të dilnim të gjithë së bashku. Pas disa ditëve qëndrimi në Kroaci, ku çdo gjë kishte funksionuar sipas planit u nisëm në Venecia. Kishim parë shumë herë foto të njerëzve të tjerë te urat e veçanta të Venecias, por tani ishim vetë atje dhe ne ishim ata që po bënin foto pranë urave e rrugëve të ngushta. Kishim frikë se mos mbaronte dhe na duhej të ktheheshim, andaj shpejtë hapin sa andej këndeje, për të mos humbur asgjë e për t'i parë të gjitha. Venecia vërtetë ishte një vend i mrekullueshëm, dhe përplot me turistë.

Pas qëndrimit në Venecia u nisëm në Slloveni, ku edhe do ta kalonim natën e fundit. Patëm rastin ta shohim qytetin nën dritat e natës ku gjithçka vezullonte. E nesërmja erdhi shpejt dhe na u desh që të niseshim për në shtëpi. Padyshim se nuk mund të kalonim pranë Dubrovnikut e të mos e vizitonim. Dubrovniku që edhe vendi surprizë i cili iu shtua listës së vendeve që vizituam gjatë asaj jave të mrekullueshme që kaluam së bashku. Një javë, kujtimi i së cilës gjithmonë do të mbetet i freskët në memorien tonë, sepse në këtë moshë arritëm që të shohim e të vizitojmë aq shumë vende e aq shumë gjëra, sa që një gjë të tillë nuk do ta kishim menduar kurrë më herët. Jo vetëm që përjetuam një javë kënaqësie por u pasuruar edhe duke marrur njohuri mbi kulturat tjera.



Schüleraustausch

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese Schüleraustausch mit Hamburg Prof. Alban Gashi

Schüler, die an einem Austausch-Programm teilgenommen haben, sollten nach dieser abgeschlossenen Maßnahme eine höhere interkulturelle Kompetenz zeigen. Dies ist besonders wichtig, da der Umgang mit Menschen aus anderen Kulturen in unserer globalen Welt von Tag zu Tag wichtiger wird. Jetzt ist es schon fast zwei Jahre her, dass ein Schüleraustausch-Projekt mit dem Gymnasium Blankenese in Hamburg ins Leben gerufen wurde. Mich freut es sehr, dass diese Tradition des Schüleraustausches fortbesteht und, dass ich schon zum zweiten Mal am Austausch teilnehmen durfte.

Am 17. April 2015, gleich nach der vierten Unterrichtsstunde, fuhren mein Kollege Richard Purschwitz, ich und 24 Schüler der elften Klasse mit dem Bus Richtung Flughafen Prishtina, um dann von dort nach Hamburg zu fliegen. Am Abend in Hamburg angekommen, trafen unsere, in Schuluniform gekleideten Schüler, bereits am Flughafen ihre Austauschpartner und Gastfamilien.

Die Austauschpartner und Gasteltern sorgten dafür, dass unsere Schüler sich in Hamburg wohl fühlten. Für unsere Schüler war es nicht nur eine Reise nach Deutschland, sondern ein Eintauchen in eine andere Kultur. Konfrontiert mit vielen neuen und ungewohnten Situationen entwickelten sie ihre Sprachkenntnisse, Fähigkeiten und Kompetenzen weiter. Das Programm gab unseren Schülern die Möglichkeit, einiges von Hamburg zu sehen und zu erleben: ausgewählte Sehenswürdigkeiten der Innenstadt Hamburgs und in Blankenese, einen Unterrichtsbesuch, eine interessante Führung bei Airbus, einen Besuch bei der Müllverbrennungsanlage in Morburg und weitere Aktivitäten mit den Gastfamilien.

Da unsere Schüler ihrerseits viel von Kosovo erzählten, bekamen unsere Partner in Hamburg ein völlig neues Bild unsere Landes. So kann man sagen, dass beide Seiten viel voneinander profitiert haben.

Nach einer Woche Aufenthalt in Hamburg kehrten wir mit vielen neuen Erfahrungen wieder nach Hause zurück. In unseren Gedanken bleibt Hamburg und eine unvergessliche Woche in Erinnerung, an die wir immer wieder gerne zurückdenken werden.



Shkëmbimi i nxënësve

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese Shkëmbimi i nxënësve me Hamburg Prof. Alban Gashi



Nxënësit që marrin pjesë në ndonjë program shkëmbimi, më vonë tregojnë kompetenca më të mëdha ndërkulturore. Kjo çështje është tejet me interes, ngase përvojat e këtilla e rrisin mirëkuptimin dhe tolerancën ndëretnike, që në botën globale është duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme. Tash e gati dy vjet më parë ka nisur një projekt shkëmbimi me nxënësit e Gjmnazit Blankenese, në Hamburg. Jam shumë i lumtur që kjo traditë shkëmbimi ende po vazhdon, posaçërisht të lumtur më bën pjesëmarrja ime qysh nga organizimi i dytë i saj.

Më 17 prill 2015, me të përfunduar ora e katërt mësimore, bashkë me kolegun tim z. Richard Purschwitz dhe me 24 nxënës të klasave të njëmbëdhjeta, u nisëm drejt aeroportit të Prishtinës, prej nga fluturuam drejt qytetit të Hamburgut. Në mbrëmje, me të arritur në aeroportin e Hamburgut, nxënësit tanë, të veshur me uniformë shkollore, u takuan me partnerët dhe me familjet e tyre nikoqire.

Kështu, partnerët dhe prindërit nikoqirë bënë të pamundurën që nxënësit tanë të ndiheshin mirë e rehat në këtë qytet. Për ta ky nuk ishte vetëm një udhëtim drejt Gjermanisë, por edhe njohje së afërmi me një kulturë të re, ku patën rastin të ballafaqohen me situata, që për ta ishin të pazakonta. Përpos kësaj, nxënësve iu dha rasti t'i thellojnë aftësitë, kompetencat dhe njohuritë e tyre gjuhësore. Programi i profilit "Weltsysteme" ua mundësoi nxënësve tanë të vizitojnë shumëçka në Hamburg, si vizitë e karakteristikave të përzgjedhura të qytetit të Hamburgut e Blankenese, vizitë e një ore të rregullt mësimore, një shetitje interesante nëpër Airbus, një vizitë deponisë së mbeturinave në Morburg dhe shumë aktivitete të tjera të organizuara me familjet e tyre nikoqire.

Meqë nxënësit tanë u kishin rrëfyer shumëçka rreth Kosovës, partnerëve nga Hamburgu iu dha një përshtypje krejtësisht tjetër nga ajo e mëhershme që kishin për vendin tonë. Rrjedhimisht mund të themi që të dyja palët përfituan ndërsjelltas nga njëra-tjetra.

Pas qëndrimit një javor në Hamburg, u kthëm në shtëpi me plot përvoja të reja. Në mendjet tona Hamburgu do të mbetet kujtim i paharruar, respektivisht një javë, të cilën do ta kujtojmë gjithmonë me plot dëshirë. . .

Schüleraustausch

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese Schüleraustausch mit Hamburg HAMBURG – Eine Woche

Hamburg, 17.04.2015

Endlich kam er, der Tag, nach Deutschland zu fliegen. Dieser Tag war etwas, auf das wir sehr neugierig waren. Es war ein Freitag und wir flogen in eine der größten Städte Deutschlands, nach Hamburg. Wir nahmen an einem Schüleraustausch teil mit einer Schule in einem Stadtviertel Hamburgs, dem Gymnasium in Blankenese: 24 Schüler unserer Schule in Begleitung von zwei Lehrern, Alban Gashi und Richard Purschwitz. Wir flogen von Pristina nach Wien und dann von Wien nach Hamburg. Als wir in Wien landeten, sah unser Freund, Andi Shemsedini, dass er einen viel späteren Flug von Wien nach Hamburg als alle andere hatte. So musste einer der beiden Lehrer, Herr Purschwitz, mit Andi fliegen. Am Ende kamen aber alle gut in Hamburg an, wo unsere Austauschschüler mit ihren Familien auf uns warteten und abholten. Dort nahmen wir in den Familien das Abendessen ein und führten verschiedene Gespräche über beide Länder. Nach dem langen Flug waren wir todmüde, wollten einfach nur ins Bett gehen und machten uns gleichzeitig gefasst auf einen tollen, unvergesslichen neuen Tag.



Hamburg, 18.04.2015

Dieser Samstag war der erste Tag unseres „Urlaubs“. Er war auch besonders, weil unser Freund Ylli Geburtstag hatte. Es war wie ein Geschenk für Ylli, als wir mit dem Schiff viele Stationen auf der Elbe ansteuerten, um in die Stadt zu gelangen. Die Aussicht vom

Schiff werden wir nie vergessen. Nach der tollen Fahrt streiften wir durch die Stadt, um einige Arbeitsblätter mit Fragen über die Sehenswürdigkeiten der Stadt zu bearbeiten. Wir waren in Gruppen mit drei oder mehr Schülern eingeteilt und es war besonders witzig, dass wir alle gleichzeitig zu den gleichen Plätzen gingen und versuchten, die Fragen schneller als die anderen zu beantworten. Das schönste was uns auffiel war, dass es in Hamburg sehr viele Brücken gibt. Das Abarbeiten der Fragen dauerte etwa eine Stunde. Danach gingen wir alle nach Hause, da wir den Rest des Tages frei hatten.

Hamburg, 19.04.2015

Am Sonntag trafen wir uns zuerst alle an der Schule und machten dann gemeinsam einen Spaziergang durch das Treppenviertel in Blankenese. Dann legten wir eine Pause beim Leuchtturm ein. Danach ging es wieder zurück zur Schule, danach in einen nahe liegenden Park. Dort aßen wir auch, was die deutschen Schüler als Verpflegung mitgebracht hatten und spielten ein bisschen Fußball. Den Abend verbrachten wir dann am Elbstrand.

Hamburg, 20. 04. 2015

Am Montag Morgen trafen wir uns mit anderen Schülern am Gymnasium Blankenese. Von dort aus fuhren wir zur deutschen Niederlassung von Airbus in Finkenwerder. Von einem Führer geleitet, besichtigten wir dieses große Unternehmen für Flugzeugbau. Dort erzählte man uns über die Geschichte des Unternehmens und über die Zusammenarbeit mit anderen Staaten. Danach zeigte man uns den Bau von Flugzeugen und ganz viele interessante Details darüber. Es war ein sehr interessantes Erlebnis für uns. Nach dem Besuch gingen manche von uns ins

Shkëmbimi i nxënësve

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese Shkëmbimi i nxënësve me Hamburg HAMBURG – Një javë

Hamburg 17.04.2015

Më në fund dita e fluturimit për në Gjermani. Dita e parë ishte diçka të cilën e prisnim me padurim. Ishte 17 prilli dhe ne fluturonim drejt njërit prej qyteteve më të mëdha të Gjermanisë, drejt Hamburgut. Ne bëmë një shkëmbin nxënësish me një pjesë të qytetit të Hamburgut të quajtur Blankenese. Aty merrnim pjesë 24 nxënës të shkollës sonë nën përcjelljen e dy profesorëve: Zotëri Alban Gashi dhe Zotëri Richard Purschwitz. Ne fluturovëm nga Prishtina për në Vjenë dhe nga Vjena për në Hamburg. Posa ateruam në Vjenë, shoku ynë Andi Shemsedini e vërejti se fluturimi i tij nga Vjena për në Hamburg ishte më vonë. Kështu u desh që njëri nga të dy profesorët të fluturonin bashkë me të dhe kështu ata u morën vesh që Zotëri Richard Purschwitz të fluturojë me të. Të gjithë ateruam mirë në Hamburg, ku na prisnin nxënësit e asaj shkolle me familjet e tyre. Ata na morën nga aeroporti dhe na dërguan në shtëpitë e tyre. Atje së bashku me familjet darkuam dhe biseduam për çështjet e dy shteteve. Pas atij fluturimi të gjatë ishim të lodhur dhe donim të flinim, u bëmë gati për një ditë të re të paharrueshme.

Hamburg 18.04.2015

Kjo ditë ishte dita e parë e udhëtimit tonë. Ajo ishte gjithashtu e veçantë sepse shoku ynë e kishte ditëlindjen. Ajo ishte si një dhuratë për Yllin sepse ne me anije nëpër shumë stacione të lumit Elbe kemi lundruar që të mund të shkonim në qytet. Pamja nga anija është e paharrueshme për ne. Pas udhëtimit të këndshëm kemi shkuar në qytet për t'i plotësuar disa pyetësorë mbi të dhëna për disa vende historike të qytetit. Kemi qenë të ndarë në grupe me nga 3 apo më shumë persona dhe pjesa më qesharake e kësaj ndarje ishte që të gjithë kemi shkuar në të njëjtat vende në kohë të njëjta dhe jemi përpjekur t'i përgjigjemi pyetjeve sa më shpejt. Gjëja më e bukur që e kemi vërejtur ishte që aty kishte shumë ura. Kjo ka zgjatur një orë dhe pas kësaj jemi kthyer të gjithë në shtëpitë tona, dhe nga kjo e kishim pjesën tjetër të ditës të lirë.



Hamburg 19.04.2015

Me 19 Prill, e diel. Së pari jemi takuar të gjithë tek shkolla. Pastaj kemi bërë një shëtitje përreth Blankenese-s. Gjatë kësaj shëtitjeje kemi zbritur disa shkallë që quhen Treppenviertel. Pastaj kemi bërë një Pausë tek Leuchtturm. Pas kësaj shëtitjeje jemi kthyer përsëri në shkollë dhe pastaj jemi relaksuar në Park. Në Park kemi ngrënë diçka që kanë sjellë nxënësit gjermanë dhe kemi luajtur futboll kundër nxënësve gjermanë. Në mbrëmje kemi shkuar tek lumi Elbe dhe aty kemi bërë qejf së bashku.

Hamburg 20.04.2015

Në mëngjesin e së hënës u takuam me nxënësit e tjerë në gjimnazin Blankenese. Nga atje udhëtuam për në kompaninë gjermane të prodhimit të aeroplanëve-Airbus. Atje të udhëhequr nga një udhërrëfyes vizituam këtë kompani të madhe të aeroplanëve. Aty mësuam për historikun e kompanisë dhe për bashkëpunimet me shtetet e tjera. Pastaj na treguan për ndërtimin e aeroplanëve dhe shumë gjëra interesante për të. Kjo ishte një eksperiencë mjaft interesante për ne. Pas vizitës së kësaj kompanie disa shkuan në kinema disa kaluan kohë me familjet dhe

Schüleraustausch

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese



Kino, andere wiederum verbrachten die Zeit mit ihrer Gastfamilie und andere wieder am Elbstrand.

Hamburg, 21. 04. 2015

Am Dienstag mussten wir früh aufstehen. Unser erstes Ziel war die Müllverbrennungsanlage in Moorburg, wo uns gezeigt wurde,

dass man Müll auch für gute Zwecke verwenden kann, denn dort wird Müll dazu benutzt, um Wasser durch das Verbrennen des Mülls zu erhitzen und zum Heizen zu verwenden. Das wäre auch eine sehr gute Idee für Kosovo. Der Gestank war zwar nicht sehr angenehm, aber es hat sich trotzdem gelohnt, diese Anlage zu besuchen. Danach haben wir erst mal richtig Pizza gegessen und uns auf dann auf den Weg gemacht, um Kanu fahren zu gehen. Kanu fahren war für einige sehr angenehm, für andere weniger, denn sie haben das Wasser „gekostet“, als unglücklicherweise eins der Bote kenterte. Die „Besatzung“ wurde von einer netten Familie gerettet. Bei diesem unfreiwilligen Bad gingen zwar ein paar elektronische Geräte kaputt, dennoch bleibt diese Kanutour für die Gruppe unvergesslich. Danach hatten wir frei, konnten machen, was wir wollten und trennten uns in kleinere Gruppen auf. Einige von uns gingen wieder an die Elbe, andere besuchten die Stadt besucht und wieder andere sahen sich einen Film an. Wieder ein unvergesslicher Tag in der schönen Stadt Hamburg.

Hamburg, 22. 04. 2015

Am Mittwoch hielten wir am Gymnasium Blankenese unsere Vorträge über die Geschichte des



Kosovo und die Mentalität unserer Menschen. Danach zeigten uns die deutschen Austauschschüler ihre Schule. Den Rest des Tages hatten wir frei. Wir gingen in die Stadt um einzukaufen. Manche von uns haben richtig viel Geld ausgegeben. Am Abend trafen wir uns alle zum Essen in einem Restaurant getroffen. Der Höhepunkt des Abends

war aber das zweite Viertelfinalspiel zwischen Atletico Madrid und Real Madrid. Nach dem Spiel machten wir uns alle mit unseren Austauschpartnern auf den Heimweg.

Hamburg, 23. 04. 2015

Nach angenehmem Schlaf standen wir früh am Donnerstagmorgen auf, um mehr über Hamburg zu erfahren. Wir fuhren mit der S-Bahn in die Schule, wo wir uns mit der Hamburger Austauschgruppe trafen. Nach vier Stunden Unterricht war dieser Schultag für uns vorbei und wir besuchten ein Kohlekraftwerk. Im Kraftwerk wurde uns von einer Mitarbeiterin erklärt, wie sorgfältig und effizient hier Kohle verwendet wird. Nach diesem anstrengenden Tag tat uns eine Party am Elbstrand gut. Den Deutschen gefiel unsere albanische Musik so gut, dass wir die ganze Zeit nur diese Musik hörten. Ungefähr um Mitternacht war die Party zu Ende. Das war unsere letzte Nacht, und deswegen genossen wir auch jeden Moment.

Shkëmbimi i nxënësve

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese



disa te tjerë shkuan në Elbe.

Hamburg 21.04.2015

Në ditën tjetër duhet të zgjoheshim herët në mëngjes. Kështu pikëtakimi ynë i parë ishte fabrika e djegies së mbeturinave. Aty pamë një prezantim se si nxehej uji duke shfrytëzuar mbeturinat si lëndë djegëse, që

do ishte një ide e mirë për Kosovën. Aroma nuk ishte edhe aq e mirë por një vizitë e tillë do ja vlente. Pastaj u afrua koha e drekës dhe u porositën pica në vlerë prej 505,50 € për tërë grupin dhe u nisëm për të bërë një lundrim me barka në lumin Elbe që kalonte nëpër qytetin e Hamburgut. Për shumicën prej nesh ishte lundrimi shumë relaksues por fatkeqësisht disa prej nesh e shijuan ujin e lumit sepse barka e tyre u rrotullua. Ata u nxorën nga një familje që jetonte afër lumit. Disa telefona nuk shpëtuan pa u prishur por atyre u mbeti diçka që nuk do ta harrojnë lehtë. Pasi përfundua lundrimin u ndamë në grupe më të vogla sepse mbrëmjen e kishim të lirë dhe disa shkuan në plazh për të festuar, disa vizituan qytetin dhe disa shkuan një film. Kështu kaluam një ditë të paharrueshme në qytetin e bukur të Hamburgut.

Hamburg 22.04.2015

Më 22.04, e Mërkurë ne bëmë disa prezantime për historinë dhe mentalitetin në Kosovë. Më vonë, nxënësit gjermanë na treguan shkollën e tyre. Pjesën tjetër të ditës e kishim të lirë.

Ne shkua në qytet për të blerë gjëra të ndryshme. Disa prej nesh shpenzuan shumë para atë ditë. Në mbrëmje shkua të gjithë së bashku në një restaurant. Ne hëngrëm dhe pimë diçka, por pjesa më interesante e natës ishte ndeshja e çerekfinaleve të ligës së kampioneve në mes Atletico Madrid – Real Madrid. Pas përfundimit të lojës ne të gjithë shkua në shtëpitë e partnerëve tanë.



Hamburg 23.04.2015

Pas një gjumi të këndshëm, filloi një ditë e re. Jemi zgjuar me shpresë se çdo ditë do të mësojmë diçka më shumë për një megapolis si Hamburgu. Si çdo herë udhëtimin më të lehtë na e bënte treni. Pastaj jemi mbledhur në shkollën gjermane ku kemi mbajtur katër orë mësimi. Ai ishte një vend shumë i arsyeshëm për t'u vizituar. Aty bënë përfitimin e energjisë elektrike në tri menyra: me anë të nxehtësisë (termocentral), me anë të ujit (hidrocentral) dhe me anë të erës. Pas vizites në vendin ku fitohet energjia elektrike u kthyem në Blankenese. Udhëtimi ishte i lodhshëm, por kur kuptuam se do e organizonim një ndenjë në breg të lumit nuk e ndjemë lodhjen fare sepse e dinim se i'a vlente lodhja atje. Të gjithë duhej të sillnin gjëra ushqimore me vete. Pasi përfundoi ajo festë u kthyem në shtëpi me partnerët sepse të nesërmen na priste një ditë e gjatë sepse duhej të ktheheshim në vendin tonë. Të gjithë ishim të lumtur e të gëzuar pasi që kemi pasur një kohë të mrekullueshme me shokët tanë, por fakti se do

Schüleraustausch

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese

Hamburg, 24. 04. 2015

Freitag war der letzte Tag, der letzte Tag einer wunderschönen Woche, die wir großartig verbracht haben. Er fing mit der Begrüßung durch unsere Gastfamilien an, danach waren wir für eine Stunde in der Schule, wo die deutschen Schüler uns über die Attraktionen von Hamburg erzählten. Nach dieser Präsentation sahen wir Fotos an, die unsere gemeinsame Woche zeigten. Am Ende unseres Besuches in Hamburg ging es zum Flughafen, wo wir uns von der deutschen Gruppe verabschiedeten und zurück nach Kosovo flogen.

Jetzt sind wir sehr gespannt auf unsere Partner, die uns bald hier in Prizren besuchen werden.



Shkëmbimi i nxënësve

Loyola-Gymnasium & Gymnasium Blankenese



ktheheshim dhe gjithë ato ditë e kujtime që i mblodhëm u erdhi fundi na merziste, edhe pse nuk e shprehnim. Për ta përshkruar atë ditë do duhej shumë kohë sepse ishte shumë e bukur. Por në pak fjalë shpresoj t'i kemi përmbledhur momentet më të veçanta të asaj dite. Me padurim presim ditën kur ata do të vijnë për vizitën e tyre në Kosovë.

Hamburg 24.04.2015

E premtdja ishte dita e fundit. Dita e fundit e një jave shumë të bukur në të cilën u kënaqëm shumë. E gjitha filloi me përshëndetjet me familjet tona mikpritëse. Pastaj shkuam në shkollë dhe bëme një orë refleksioni gjatë të cilës nxënësit gjermanë prezantuan vendin e tyre dhe disa nga atraksionet e Hamburgut. Me mbarimin e këtyre prezantimeve ne pamë disa foto tona që e përmbledhnin javën. Qëndrimin tonë në Hamburg i erdhi fundi. Kur mbërritëm në aeroport u përshëndetëm me grupin gjermanë dhe së fundmi ne u nisëm për në Kosovë.

Schüleraustausch

Loyola-Gymnasium & Friedrich-List-Gymnasium Schüleraustausch mit Gemünden Prof. Vlora Grajgevcic & Prof. Neki Jahaj

Unser jährlicher Schüleraustausch mit dem Friedrich-List-Gymnasium in Gemünden/Bayern fand auch dieses Jahr wieder statt. In der dritten Aprilwoche besuchten uns die Gemündener Schülerinnen und Schüler.

Während dieser Woche wurden verschiedene Aktivitäten unternommen. Wir besuchten auch das so genannte „Weiße Haus“, das Rathaus von Prizren, in dem uns Vizebürgermeister Lulzim Kabashi herzlich begrüßte. Er informierte die deutschen Schüler über die Stadt Prizren und zuletzt stand er auch zur Verfügung, um auf die vielen Fragen unserer Schüler zu antworten. Gleich danach machten wir uns auf den Weg, um die wunderschönen Berge von Peja zu sehen. Wir fuhren also ins Rugova-Tal, wo immer noch Schnee lag. So konnten wir noch im April eine Schneeballschlacht veranstalten.

Während dieser Woche hatten die deutschen Schüler auch die Möglichkeit, das KFOR-Lager zu besichtigen, in dem Soldaten der Deutschen Bundeswehr seit Kriegsende eingesetzt sind. Die Schüler wurden durch das Camp geführt und informiert. Zuletzt gab es dann auch noch ein Mittagessen zusammen mit den deutschen Soldaten. An unserem Tag der offenen Tür konnten sich die deutschen Schüler amüsieren, leckere traditionelle kosovarische Speisen kosten und neue Bekanntschaften knüpfen. Dieses Jahr war aber etwas Besonderes für unsere deutschen und kosovarischen Schüler. Denn unsere deutschen Gäste wurden dieses Jahr in Gastfamilien untergebracht. Sie erzählten viel Gutes, vor allem aber, dass die Familien sehr gastfreundlich waren.

Der Gegenbesuch stand dann im Juni an. Für viele kosovarische Schüler war das der erste Flug und wir mussten bei dem einen oder anderen auch Händchen halten. In Stuttgart angekommen, erwartete uns schon unser lustiger Busfahrer zusammen mit Herrn Jürgen Endres. Nach ungefähr vier Stunden Fahrt kamen wir in Gemünden an, wo uns die Familien zusammen mit den deutschen Schülern erwarteten. Alle freuten sich über das Wiedersehen, was in den Gesichtern der Schüler deutlich zu sehen war. Am nächsten Tag stand ein Unterrichtsbesuch in



Shkëmbimi i nxënësve

Loyola-Gymnasium & Friedrich-List-Gymnasium Shkëmbimi i nxënësve me Gemünden Prof. Vlora Grajgevcic & Prof. Neki Jahaj



Si çdo vit tjetër edhe këtë vit u mbajt shkëmbimi i nxënësive me Gjimnazin Friedrich List në Gemünden. Në javën e tretë të prillit Gemündasit na vizituan neve.



Përgjatë kësaj jave u bënë aktivitetet të ndryshme, ndër të

tjera u vizitua Shtëpia e Bardhë, ku u pritëm nga zëvendësi i kryetarit të komunës, Z. Lulzim Kabashi. Ai i informoi nxënësit gjermanë dhe ata kosovarë rreth qytetit të Prizrenit dhe në fund nxënësit, patën rastin që të parashtronjë pyetje rreth atyre që u interesonin. Menjëherë pas kësaj u vazhdua rruga për në luginën e Rugovës, ku kishte ende borë. Kështu edhe në prill fëmijët shfrytëzuan rastin të luanin me topa bore.

Përgjatë kësaj jave nxënësit gjermanë patën rastin të vizitojnë edhe kampin fushor të KFOR-it, ku janë të stacionuar ushtarët nga vendi i tyre që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Atyre iu ofrua një shetitje në kamp me ç'rast edhe u informuan për punën që bëhej aty. Në fund ata shijuan edhe drekën e shijshme në menzë së bashku me ushtarët. Ditën e Dyerve të Hapura nxënësit gjermanë u relaksuan, provuan ushqime tradicionale dhe lidhën kontakte të reja edhe me nxënës tjerë nga shkolla. Ky vit ishte paksa më i veçantë për nxënësit gjermanë dhe ata kosovarë, sepse nxënësit gjermanë u akomoduan në familjet e nxënësve kosovarë. Ata treguan për shumë gjëra të mira, të cilat i kishin përjetuar në familjet nikoqire.

Në qershor iu kthye vizita nxënësve gjermanë. Për shumë nxënës kosovarë ishte ky udhëtimi i parë me aeroplan dhe për këtë arsye duhej një kujdes pak më i shtuar për ta. Në Shtuttgart takuam z. Jürgen Endres, i cili po na priste bashkë me shoferin e autobusit, dhe pas rreth katër orësh arritëm në Gemünden. Aty ishin duke na pritur nxënësit gjermanë së bashku me familjarët e tyre. Tek nxënësit vërehej një gëzim i madh që po takoheshin përsëri në Gemünden. Ditët në vijim ishte në program vizita e mësimit në shkollën nikoqire. Nxënësit kosovarë u përshëndetën nga drejtori i shkollës Walter Fronzeck, dhe më në fund nxënësit tanë patën mundësinë të njiheshin për së afërmi me sistemin e shkollimit gjerman. Po në të njëjtën ditë u organizua edhe një shetitje në qytetin Gemünden, ku nxënësit duhej ta bënin një kuiz. Rezultatet ishin vërtetë të kënaqshme.

Ditët në vijim udhëtuan për në Würzburg për ta vizituar një qendër të arsimit për të rinjë. Aty morën pjesë në seminare të ndara në grupe dhe patën mundësi të dëgjojnë për projekte të ndryshme, në mes të tjerash edhe për „shkollat pa racizëm“. Këto seminare ishin dobiprurëse si për nxënësit kosovarë ashtu edhe për ata gjermanë. Nga aty u mundua të tregohej bota në një kënd ndryshe dhe kjo u solli kënaqësi nxënësve. Në Kosovë veç u ishin bërë fotografi të ndryshme nxënësve në tri veshje të ndryshme, një elegante, një veshje normale dhe një në uniformë të shkollës. Këtë e bënë edhe nxënësit gjermanë. Gjatë një vizite në komunë u prezantua projekti i bërë ku u ekspozuan fotografitë dhe kështu të interesuarit patën mundësi

Schüleraustausch

Loyola-Gymnasium & Friedrich-List-Gymnasium

unserer Partnerschule auf dem Programm. Wir wurden vom Schuldirektor begrüßt und endlich konnten wir das deutsche Schulsystem genauer kennen lernen. Am gleichen Tag fand eine Stadtbesichtigung statt, bei der die Schüler dann auch Rätsel lösen mussten. Die Ergebnisse waren recht zufriedenstellend.

Dann fuhren wir auch nach Würzburg, um eine Jugendbildungsstätte zu besuchen. Dort nahmen die Schüler an einem Seminar teil, in dem sie über das Thema: Schulen ohne Rassismus aufgeklärt wurden. Nach dem Mittagessen wurden die Schüler in Gruppen aufgeteilt, welche dann in verschiedenen Workshops zu diesem Thema arbeiteten. Diese Workshops waren sowohl für die deutschen als auch für die kosovarischen Schüler sehr gewinnbringend. Nun sahen sie die Welt nicht nur anders, sondern diese Arbeitsform hatte auch Spaß gemacht. Bei einem Besuch im Rathaus von Gemünden wurde das Projekt vorgestellt und die Bilder aufgehängt, wo man sie dann betrachten konnte.

Am nächsten Tag ging es dann in die Großstadt Frankfurt, wo es wieder Informationen über die Stadt gab. Die Schüler besichtigten ein Museum für Sehbehinderte und am Nachmittag konnten sie in den großen Kaufhäusern auch kleine Geschenke für die Familien kaufen.

Schnell verging die Woche und schon stand der Rückflug an. Mit weinenden und traurigen Gesichtern verabschiedeten sich viele Schüler voneinander. Es ging zurück nach Hause, wo der normale Alltag begann. Für viele Loyolaner werden diese Tage und ihre Austauschpartner unvergesslich bleiben.



ti shikonin ato.

Në ditën tjetër shkuam në një qytet më të madh, në Frankfurt, ku kishte përsëri informacione të reja për qytetin. Aty nxënësit vizituan një muze për të verbërit dhe për një orë të tërë u udhëhoqën nga të verbërit. Ditën e fundit nxënësit u lanë të lirë që së bashku me partnerët e tyre të dalin në qytet dhe të blejnë dhurata për familjet e tyre.

Kështu iku java shumë shpejt. Me lot në sy u përshëndetën nxënësit me njëri-tjetrin. U kthyer prap në shtëpi ku po na prishte përditshmëria e shkollës. Për shumë nga nxënësit dhe partnerët e tyre këto ditë do të jenë paharruara.

Shkëmbimi i nxënësve

Loyola-Gymnasium & Friedrich-List-Gymnasium

19. Juni 2015
MAIN POST

Fotos entlarven das Schubladendenken

Gemündener und kosovarische Gymnasiasten zeigen im Kulturhaus eine Ausstellung gegen Vorurteile

Von unserem Mitarbeiter
FERDINAND HEUGENTHAL

GEMÜNDEN Der seit sechs Jahren bestehende Schüleraustausch des Friedrich-List-Gymnasiums mit dem Loyola-Gymnasium in Prizren, Kosovo, ist eine Erfolgsgeschichte. Die Freundschaft mit den Schülern des jüngsten europäischen Landes, in dem die Hälfte der 1,8 Millionen Einwohner unter 25 Jahre alt ist, gestaltet sich in vielen Dingen anders als Partnerschaften mit Schulen der in der EU etablierten Länder wie Frankreich oder Italien.

In diesem Jahr nahmen 60 Jugendliche der neunten Klassen des FLG am Austausch teil, so viel wie nie zuvor, berichtete Lehrer Jürgen Endres, der schon mehrmals die Fahrten nach Prizren organisiert hat. Da sich beide Schulen aktiv gegen Ausgrenzung und Diskriminierung einsetzen, haben die Jugendlichen ein Fotoprojekt zu diesem Thema erarbeitet, das sie am Mittwoch in einer Vernissage im Kulturhaus im Beisein von Bürgermeister Jürgen Lippert und Kulturamtschefin Janna Blatz präsentierten.

Auf zwölf Tafeln mit je drei Fotos ist dreimal dieselbe Person abgebildet, zuerst in Landestracht, dann in

Schulkleidung oder mit ausgefallenen Frisuren und schließlich, drittens, in Freizeitkleidung, wie sie international getragen wird. Der Betrachter soll dadurch erkennen, dass die erste Darstellung eine gewisse Zuordnung, ein Schubladendenken erzeugt, während die weiteren Bilder

vorurteilsfrei erklären: „Das ist ein Mensch wie du und ich.“ Unterstützung und Anregung für die Projektarbeit hatten die Schüler unter anderem in mehreren Workshops an der Jugendbildungsstätte Würzburg sowie beim Besuch des Dialog-Museums in Frankfurt gefunden. Bür-

germeister Jürgen Lippert hieß die jungen Leute aus dem Kosovo, die seit einigen Tagen mit ihrer gepflegten Schulkleidung das Straßenbild in Gemünden bereichern, willkommen. Unter ihnen ist auch der Deutschlehner Neki Jahaj, der sich nach mehreren Besuchen in der

Dreiflüßstadt bereits sehr gut auskennt. Lippert verfolgte aufmerksam die Powerpoint-Präsentation, die von der Schülerin Vesa Hoti und ihrem Klassenkameraden Florian Hosoda in vorzüglichem Deutsch vorgetragen wurde.

Die beiden Neumittelklasser stellten ihre Heimatstadt Prizren sowie das vor zehn Jahren durch den Jesuitenpater Walter Happel gegründete Loyola-Gymnasium vor und gaben aufschlussreiche Einblicke in den Schulalltag der 700 Gymnasiasten und 80 Grundschüler. Ein Schmunzeln ging durch die Reihen der Gastgeber, als Florian Hosoda erklärte, dass im Internat um 21 Uhr die Handys abgegeben werden müssen, damit die Schüler am nächsten Tag ausgeschlafen haben. Ein respektvolles Nicken war zu erkennen, als die Bemerkung fiel: „In der Loyola-Schule haben wir mehr Unterrichtsstunden als in den anderen Schulen im Kosovo – aber wir wollen das auch so.“

Die Ausstellung „Augen auf! – Gegen Ausgrenzung und Diskriminierung“ ist zu den üblichen Öffnungszeiten des Kulturhauses „Alte Schule“ in der Gemündener Obertorstraße noch bis zum 3. Juli im Kulturhaus Gemünden zu sehen.



Aktiv gegen Diskriminierung: Die Schüler Vesa Hoti und Florian Hosoda stellten im Gemündener Kulturhaus das Gymnasium und ihre Heimatstadt Prizren vor.

FOTO: FERDINAND HEUGENTHAL

Klasse - Klasa - I a

Klasse - Klasa - I b

Kollegium der Grundschule



Fejzullah Berisha
Olsa Berisha
Rrina Berisha *
Rrona Berisha
Florian Biffar
Breron Bobaj
Andrea Dushi
Rrezon Kabashi
Glorja Kala
Pëllumb Kastrati
Sadik Kyçyku
